

ROLI I TEKSTIT LETRAR NË MËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

Ma. Sonila Alla

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (ESP)

Universiteti i Mjekësisë

E-mail: allasonila@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Poezia në veçanti dhe teksti letrar në tërësinë e tij është një nga format më artistike të përdorimit të gjuhës. Krahas anës së tij artistike, padyshim që ky lloj teksti mund të gjejë përdorim të gjerë edhe në klasën e gjuhës së huaj duke u përdorur në forma të ndryshme, si në të folur ashtu edhe në të shkruar.

Vendi që zë teksti letrar në programet shkollore të mësimin të gjuhës së huaj mbetet ende i papërfillshëm dhe jo i mirëmenduar duke marrë parasysh edhe natyrën e aktiviteteve të propozuara në tekst. Në këtë pikë është detyra dhe privilegji i mësuesit të gjuhës që t'i japë rëndësinë dhe vendin që i takon tekstit letrar në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj. Vendosija e herëpashershme e tekstit letrar në qendër të procesit mësimor sjell një sërë avantazhesh, sidomos në aspektin e motivimit të nxënësve dhe në krijimin e një ambienti tërheqës për zhvillimin e orës së mësimin.

Fjalët çelës: poezi - imagjinatë – motivim – kreativitet – shprehje në të folur

ABSTRACT

Literary text in general and poetry in particular is one of the artistic forms of the language use. Apart from its artistic form, this kind of text can be widely used even in foreign language classes in different ways, either in spoken or written language. The place that literary text occupies in school programs of foreign languages still remains negligible considering the nature of the activities proposed in the text. In this point, it's the duty and privilege of the foreign language teacher to give the right importance to the literary text during the process of learning and teaching of a foreign language. Frequently placing the literary text in the centre of teaching and learning brings forth numerous advantages, especially in the aspect of motivating students and creating an attractive environment during this process.

Keywords: poetry, literary text, motivation, creativity, spoken language.

Hyrje

Mësimi i një gjuhe të huaj është eksplorimi i një mënyre tjetër për të parë botën, zbulimi i një universi kulturor dhe gjuhësor të ndryshëm nga ai i origjinës. Procesi mësimor në vetvete kërkon aplikimin e strategjive të ndryshme mësimore me qëllim krijimin e një ambienti pozitiv dhe motivues për nxënësit.

Në mbështetje të idesë së mësipërme, hipoteza e punimit tonë do të jetë: a mundet teksti letrar dhe ai poetik të shërbejnë si materiale mësimore të rëndësishme dhe të pasura, duke qenë se nëpërmjet tyre gjuha trajtohet në të gjitha dimensionet e saj, duke përfshirë leksikun, gramatikën, ndërtimin sintaksor si edhe idetë e reja që teksti propozon?

Nisur edhe nga ajo çka ne vetë kujtojmë në lidhje me orët mësimore të gjuhës së huaj, teksti poetik apo letrar zinte pak vend dhe ato pak materiale të propozuara në metodë zakonisht mësoheshin përmendësh, duke neglizhuar çdo lloj mundësie tjetër për ta trajtuar në funksion të procesit mësimor.

Nisur nga ky fenomen, jemi përpjekur të shohim më në detaje vendin që zë dhe rolin që luan teksti letrar dhe ai poetik në metodat e gjuhëve të huaja të përdorura në Shqipëri. Duke qenë të vetëdijshëm se aplikimi dhe trajtimi i këtij lloj teksti është i limituar, mbetet për t'u parë nëse kjo gjithashtu është një nga arsytet që nxënësit nuk janë aspak të motivuar gjatë orës së mësimi, përkundrazi shfaqin ndjenjë e monotonisë si pasojë e trajtimit të gjuhës kryesisht në aspektin gramatikor të saj.

Punimi ynë është ndarë në tri çështje kryesore. Në pjesën e parë është trajtuar ana teorike lidhur me historikun e tekstit letrar përdorur si material pedagogjik dhe funksionet e tij në klasën e gjuhës së huaj. Pjesa e dytë është fokusuar në rëndësinë e përzgjedhjes së tekstit letrar, duke marrë parasysh një sërë kriteresh, ndërsa në pjesën e tretë është paraqitur ana praktike e punimit, e cila konsiston në vëzhgimin dhe studimin e tri metodave të gjuhëve të huaja për të qartësuar rolin dhe vendin e tekstit letrar në procesin mësimor. Krahas kësaj, me studentë të gjuhës angleze kemi punuar materiale të ndryshme poetike me qëllim motivimin e studentëve, por edhe testimin e rëndësisë së tekstit poetik si element mbështetës në procesin mësimor. Nëpërmjet këtij aktiviteti praktik jemi përpjekur t'i përgjigjemi problematikës së shtruar më sipër.

1. Teksti poetik si material mbështetës në klasën e gjuhës së huaj

Mësimdhënia dhe mësimnxënia janë po aq të vjetra sa vetë njerëzimi. Nevoja për të mësuar dhe për t'u njohur me gjithçka që ndodh në ambientin që na rrethon kanë nxitur njeriun të mësojë dhe të eksplorojë veten dhe të tjerët.

Metodologjitë e të nxëniet kanë qenë gjithmonë në proces ndryshimi të vazhdueshëm, krahas tyre ndryshim të dukshëm kanë pësuar edhe materialet mbështetëse të përdorura gjatë procesit të të nxëniet. Duke i mëshuar idesë së mësipërme, punimi ynë gjithashtu është përqendruar tek materialet mbështetëse gjatë një ore mësimi të gjuhës, ndaj pyetja që kemi drejtuar fillimisht është : A ndihmon teksti poetik në procesin e të nxëniet?

Sipas M. Patin-it, padyshim¹ teksti poetik ndihmon në procesin e të nxëniet, por jo në çdo aspekt dhe në çdo kohë. Studime të ndryshme pedagogjike kanë vërtetuar se letërsia në përgjithësi dhe teksti poetik në veçanti, nuk mund të shërbejnë si materiale mësimore efektive në çfarëdolloj periudhe kohore. Në periudha të caktuara, teksti letrar dhe ai poetik janë trajtuar në forma të ndryshme gjatë procesit të të nxëniet.

Metodologjia tradicionale e shfaqur në fund të shekullit XVI-të i ka dhënë tekstit letrar dhe atij poetik një vend tejet thelbësor në procesin e të nxëniet. Teksti poetik kryesisht ishte baza e çdo aktiviteti në klasën e gjuhës së huaj dhe gjithashtu aplikimi i tij shërbente si një mjet për të depërtuar në kulturën dhe qytetërimin e secilës gjuhë.

Ndryshe nga metodologjia tradicionale në thelb të metodologjisë direkte qëndron gjuha e folur, por duke e përjashtuar totalisht tekstin letrar si mjet të domosdoshëm për zhvillimin e aftësive komunikative. Sipas mbështetësve të kësaj metodologjie, teksti letrar dhe ai poetik shfaqen me tepër si pengesa për përvetësimin e gjuhës së huaj.

Në ndryshim nga metodologjia direkte, ajo që konsiderohet si metodologjia aktive risjell edhe njëherë në qendër të procesit tekstin letrar dhe atë poetik. Periudha e zbatimit të kësaj metodologjie në mësimdhënie është konsideruar gjithashtu si periudha e rikthimit të tekstit të shkruar letrar.

1 Patin, M. (1848). *La poésie didactique à ses différents âges*.

Nuk duhet lënë pa përmendur edhe rasti i metodologjisë² audio-vizive i cili është i njëjtë me atë të metodologjisë direkte, pra teksti letrar përjashtohet tërësisht nga procesi mësimor. Nga vetë emri, metodologjia audio-vizive përdor si elemente didaktikë vetëm materialet audio-vizive.

Funksionet e tekstit poetik

Teksti poetik si mbështetës didaktik në mësimin e gjuhës së huaj nuk ka qenë në qendër të debateve pedagogjike, krahasuar me elementë të tjerë si gramatika, linguistika apo leksiku. Metodologjitë e vjetra të mësimdhënies e kanë integruar tekstin poetik vetëm për të arritur plotësimin e objektivave gramatikore dhe leksikore dhe në raste të tjera kanë shërbyer si materiale të cilat mbartin më shumë vlera kulturore sesa gjuhësore.

Me shfaqjen e metodologjive komunikative, teksti poetik vendoset në një tjetër pozicion dhe trajtohet si një element i rëndësishëm didaktik pasi ofron një fjalor të pakushtëzuar në sasi dhe në cilësi, por gjithashtu ndihmon edhe në rritjen e imagjinatës dhe krijimtarisë të nxënësit. Thënë ndryshe, përdorimi i tekstit poetik në klasën e gjuhës së huaj ka disa funksione, ndër të cilat mund të përmendim: funksioni poetik, funksioni psikologjik, funksioni komunikativ, funksioni social, funksioni ndërkulturor etj.

Gjithashtu, që prej fillimit ne kemi nënvizuar faktin se poezia nuk mund të trajtohet vetëm në aspektin gramatikor apo leksikor të saj. Nëpërmjet tekstit poetik nxënësi zhvillon më së miri aftësitë në të folur e në të shkruar. Njëkohësisht, një sërë objektivash dhe aktivitete të tjera gjuhësore gjejnë vend për t'u zbatuar në klasën e gjuhës së huaj, ndër të cilat përmendim: objektiva gjuhësore, objektiva leksikore, objektiva gramatikore, objektiva fonetike.

2 Puren, Ch. (1988). *Histoire des méthodologies de l'enseignement des langues*. Paris: Nathan-CLE International

2. Kriteret për përzgjedhjen e tekstit poetik në klasën e gjuhës së huaj

Efikasiteti i tekstit poetik si element mbështetës në mësimdhënie varet kryesisht nga përzgjedhja që bëjmë. Para se të përzgjedhim tekstin me të cilin do të punojmë duhet të marrim në konsideratë disa elemente të rëndësishme si: niveli i nxënësve, tematikat e tyre të preferuara, koha në dispozicion, objektivat për t'u arritur gjatë orës së mësimi etj.

Teksti poetik mund të trajtohet më së miri në të gjitha nivelet e gjuhës nëse mësuesi tregon kujdesin e duhur në përzgjedhjen si të materialeve, ashtu edhe të aktiviteteve që do të zhvillojë gjatë seancës mësimore. Përcaktimi i objektiveve është gjithashtu një element po aq i rëndësishëm, ndaj përzgjedhja e materialit letrar duhet të jetë gjithmonë në funksion të objektiveve të paracaktuara nga mësuesi dhe t'i shërbejë interesit të klasës.

Krahas kësaj,³ mësuesi i gjuhës nuk duhet absolutisht të anashkalojë faktin se gjithmonë do të gjendet përpara një klase heterogjene ku secili nga nxënësit mbart një bagazh të ndryshëm kulturor, gjuhësor apo edhe letrar. Në këtë pikë, është detyra e mësuesit që të zbatojë një metodologji të diferencuar, pra, pavarësisht përzgjedhjes së tekstit poetik, aktivitetet e propozuara duhet të mbërrijnë tek çdo nxënës dhe të zgjojnë interesin e gjithsecilit. Puna në grup, loja me role apo edhe zhvillimi i pjesëve teatrale në klasë do të ndihmojnë që materiali i përzgjedhur të jetë gjithëpërfshirës.

Nëse teksti poetik nuk arrin të përshtatet me nevojat e nxënësit apo të klasës në tërësi, rrezikon ta humbasë funksionin dhe vlerën e tij si element mbështetës në procesin e mësimdhënies.

Më poshtë, mund t'ju paraqesim disa prej zgjedhjeve që duhet të bëjë mësuesi i gjuhës duke respektuar kriteret e përmendura më lart.

- *Një tekst original apo të përkthyer?*

Mësuesi i gjuhës nuk duhet të jetë në dilemë midis një teksti të përkthyer dhe një teksti original. Ky i fundit padyshim mbetet gjithmonë modeli ideal i gjuhës, ndërkohë që një tekst i përkthyer mbart me vete disa nga mangësitë e mëposhtme:

3 Collés, L. (2014). *La poésie en classe de FLE*

- Përkthyesi nuk mundet ta sjellë të pandryshueshme idenë e autorit
- Teksti i përkthyer rrezikon të na paraqesë struktura gramatikore të cilat nuk janë ato të gjuhës origjinale.
- Poezia në veçanti do ta humbiste formën e saj nëse paraqitet si material i përkthyer, duke marrë parasysh këtu ndryshimet në rimë apo edhe në vargje të cilat luajnë një rol tejet të rëndësishëm në trajtimin e gjuhës.

- *Tekst klasik apo modern ?*

Të dyja tekstet, qoftë ai klasik apo modern janë tejet frytdhënës nëse trajtohen në klasën e gjuhës së huaj, por kemi konstatuar gjithsesi se teksti poetik bashkëkohor sjell më shumë avantazhe në procesin mësimor.

Së pari, një tekst poetik klasik ka një strukturim gramatikor dhe leksikor tejet të vështirë për nxënësin. Krahës kësaj, strukturat gjuhësore të paraqitura në tekstet klasike mund të mos përdoren më as në gjuhën e shkruar dhe aq më pak në atë të folur.

Së dyti, temat e trajtuara në një tekst poetik klasik zakonisht nuk janë aspak aktuale, gjë që ndikon drejtpërdrejt në humbjen e interesit nga ana e nxënësve.

- *Një tekst bruto apo i përpunuar?*

Zakonisht tekstet poetike të përpunuara pësojnë ndryshime të mëdha për sa i përket fjalorit (fjalë të zëvendësuar), sintaksës (fjali të rindërtuara) dhe strukturës (heqje të strofave apo dhe shtim të tyre). Kjo lloj praktike e modifikimit të tekstit justifikohet me faktin e realizimit të një teksti më tërheqës dhe më të thjeshtuar për nxënësin, por nga ana tjetër kjo shfaqet si mangësi e madhe pasi e zhvesh tekstin nga çdo vlerë gjuhësore apo kulturore. Detyra e mësuesit është të përdorë gjithmonë tekstin origjinal, duke qenë se pasuria leksikore që ky i fundit mbart i mundëson ta trajtojë materialin në disa plane gjuhësore dhe gramatikore.

3. Vendi i tekstit poetik në metodat e gjuhëve të huaja

Në vijim të punës tonë kemi konstatuar se përdorimi i tekstit letrar në përgjithësi si element mbështetës në procesin mësimor ka pësuar ndryshime të vazhdueshme.

Rëndësia, mënyra e trajtimit si edhe vendi që teksti letrar zë në metodat e gjuhëve të huaja, shkakton një problematikë më vete e cila duhet analizuar. Duke marrë shkas nga kjo problematikë, kemi ngritur pyetjet e mëposhtme :

- Çfarë vendi zënë tekstet letrare në metodat e gjuhëve të huaja të përdorura ne Shqipëri?
- Në çfarë mënyre janë përshtatur ato?
- Cilët janë llojet e aktiviteteve të propozuara?

Për t'ju përgjigjur pyetjeve të mësipërme, ne kemi analizuar tri metoda të ndryshme të cilat përdoren aktualisht në arsimin 9-vjeçar dhe atë të mesëm, përkatësisht: Alter Ego 4 (metodë e gjuhës frënge), On Screen B2+ (metodë e gjuhës angleze) dhe Progetto Italiano B1 (metodë e gjuhës italiane).

Tabela e mëposhtme paraqet analizën e tri metodave të gjuhëve të huaja duke u bazuar në kriteret e mëposhtme :

- a. Numri i teksteve letrare dhe poetike të përfshira në secilën metodë.
- b. Prezantimi i teksteve letrare (informacionet rreth materialit të propozuar në metodë).
- c. Natyra e aktiviteteve të propozuara nga metoda duke patur gjithmonë si orientim tekstin letrar.

Metodat	Tekste letrare	Tekste poetike	Prezantimi i teksteve	Aktivitetet e propozuara
Alter Ego B2	10 tekste	1 tekst	- Autori - Titulli i materialit - Data e botimit - Shtëpia botuese	- Pyetje për të kuptuar tekstin - Ushtrime gramatikore lidhur me tekstin - Trajtim i rubrikës të të shkruarit duke u nisur nga tema e tekstit letrar - Koment mbi tekstin
On Screen B2+	0 tekste	0 tekste		-
Progetto Italiano B1-B2	0 tekste	2 tekste	- Autori	- Pyetje rreth tekstit - Ushtrime gramatikore

Rezultatet:

a. Numri i teksteve letrare dhe poetike të paraqitura në metodat e vëzhguara

Duke vëzhguar dhe analizuar tri metodat e përmendura më lart, kemi konstatuar se teksti letrar gjen përdorim në klasën e gjuhës së huaj pavarësisht pranisë së ulët apo të lartë të tij. Jo pa qëllim janë marrë në vëzhgim tri metoda të cilat i përkasin të njëjtit nivel gjuhe, pra niveli B2. Përzgjedhja e këtij niveli është bërë duke marrë parasysh njohuritë dhe kapacitetin leksikor që nxënësit disponojnë, që do të thotë ata janë të aftë të kuptojnë dhe trajtojnë më së miri një tekst letrar apo poetik.

Vëmë re se në metodën Alter Ego të gjuhës frënge na paraqiten në total 11 tekste letrare, ku njëri prej tyre është tekst poetik. Ky rezultat është tejet i kënaqshëm dhe befasues në të njëjtën kohë duke marrë parasysh metodat e gjuhëve të tjera. Përmendim këtu rastin e metodës së anglishtes On Screen, e cila nuk ka as edhe një tekst letrar apo poetik, por është përqendruar më së shumti në materialet autentike.

Ndryshe nga metoda e gjuhës angleze, ajo e italishtes Progetto Italiano përmban dy tekste poetike të trajtuara kryesisht në funksion të gramatikës.

b. Prezantimi i teksteve në metodë

Në metodat e vëzhguara, konstatojmë se informacioni rreth teksteve letrare është tejet i kufizuar dhe nuk ofron asnjë orientim për nxënësin me përjashtim të disa elementeve biografike të cilat shoqërojnë tekstin (autori, titulli i veprës, viti i botimit, shtëpia botuese).

c. Aktivitetet e propozuara

Në të tri metodat e paraqitura, teksti letrar është trajtuar më shumë si një element plotësues në klasën e gjuhës, sesa si një material më vete për t'u analizuar në gjuhën përkatëse. Natyra e aktiviteteve të propozuara lidhet kryesisht me të kuptuarit e tekstit, me pjesën gramatikore si edhe atë leksikore. Rubrikat e tjera

(të nxënit, të shkruarit dhe të folurit) përfaqësohen nga ushtrime të tipit: lexim pa zë, loja me role, ritregim i pjesës letrare etj.

Vërejmë gjithashtu ushtrime të cilat lidhen me krijimtarinë në gjuhën e huaj, por edhe në këtë rast ato janë të lidhura ngushtë me tekstin e paraqitur dhe me strukturën e tij, përmendim këtu ushtrime të llojit “shkruani një tekst të ngjashëm duke respektuar stilin e autorit”.

Nga njëra anë këto lloj aktivitete ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësitë e të shkruarit në gjuhë të huaj, por nga ana tjetër ato shfaqin më shumë një natyrë “detyruese” duke e penguar nxënësin të shprehet lirshëm. Të qenit “rob” i tekstit të propozuar në metodë mund të jetë penalizuese pasi nuk i motivon aspak individët e një klase të gjuhës së huaj dhe rrjedhimisht nuk i inkurajon ata të shfaqin apo të testojnë aftësitë e tyre krijuese.

Teksti poetik si element mbështetës në krijimet letrare

Sikurse e kemi nënvizuar disa herë, teksti letrar në përgjithësi dhe ai poetik në veçanti luajnë një rol tejet të rëndësishëm dhe të dobishëm në klasën e gjuhës së huaj. Konstatim ky i mbështetur edhe nga studiues të ndryshëm: “*L'idée demeure encore que la littérature constitue un élément de civilisation essentiel et que son étude constitue l'achèvement de l'apprentissage du français*” (Mouginot, 2014. P. 10)

Në citimin e mësipërm një nga studiuesit më në zë të gjuhësisë pohon se ideja e përdorimit të tekstit poetik, qëndron në faktin se letërsia përbën elementin kryesor të qytetërimit dhe studimi i saj e shpie mësimin e gjuhës së huaj në një tjetër nivel. Pra, nëpërmjet përdorimit të tekstit poetik procesi mësimor mund të zhvillohet më së miri duke prekur të gjitha kompetencat e një gjuhe të huaj. Krijimet letrare gjatë procesit të të nxënit janë jo vetëm interesante por edhe tërheqëse për orën mësimore pasi një tekst poetik na lejon të luajmë me elementë të gjuhës si: fjalët, kuptimin, ritmin, rimën etj.

Për të ilustruar përkufizimet e përmendura më sipër janë propozuar tri ushtrime me karakter letrar për studentët e qendrës së gjuhëve të huaja

- 4 Mouginot, O. (2014). L'atelier d'écriture créative en didactique du français langue étrangère. Mémoire de master: Sciences du langage, Paris: Université Sorbonne Nouvelle – Paris 3.

« Solution ». Këto ushtrime janë të bazuara në tekste të mirëfillta letrare të poetëve Ernest Heminguej dhe Edgar Allan Poe. Krahas kësaj, me vullnet të lirë studentëve iu është kërkuar të krijojnë ata vetë një tekst poetik.

Ushtrimet e propozuara janë si më poshtë vijon:

1. *Shkruani një tekst poetik duke u bazuar në vargjet e para të poezisë së Ernest Heminguej.*

Advice to a Son

Never trust a white man,
Never kill a Jew,
Never sign a contract,
Never rent a pew.
Don't enlist in armies;
Nor marry many wives;
Never write for magazines;
Never scratch your hives.
Always put paper on the seat,
Don't believe in wars,
Keep yourself both clean and neat,
Never marry whores.
Never pay a blackmailer,
Never go to law,
Never trust a publisher,
Or you'll sleep on straw.
All your friends will leave you
All your friends will die
So lead a clean and wholesome life
And join them in the sky.

Ernest Hemingway

2. Krijoni një tekst të ri letrar duke u nisur nga poezia e mëposhtme.

Alone

From childhood's hour I have not been
As others were—I have not seen
As others saw—I could not bring
My passions from a common spring—
From the same source I have not taken
My sorrow—I could not awaken
My heart to joy at the same tone—
And all I lov'd—I lov'd alone—
Then—in my childhood—in the dawn
Of a most stormy life—was drawn
From ev'ry depth of good and ill
The mystery which binds me still—
From the torrent, or the fountain—
From the red cliff of the mountain—
From the sun that 'round me roll'd
In its autumn tint of gold—
From the lightning in the sky
As it pass'd me flying by—
From the thunder, and the storm—
And the cloud that took the form
(When the rest of Heaven was blue)
Of a demon in my view—

Edgar Allan Poe

3. *Ndërttoni një tekst poetik duke ndërhyrë midis vargjeve të poezisë së mëposhtme.*

A dream Within A dream

Take this kiss upon the brow!

.....

And, in parting from you now,

.....

Thus much let me avow —

.....

You are not wrong, who deem

.....

That my days have been a dream;

.....

Yet if hope has flown away

.....

In a night, or in a day,

.....

In a vision, or in none,

.....

Is it therefore the less *gone*?

.....

All that we see or seem

.....

Is but a dream within a dream.

.....

I stand amid the roar

.....

Of a surf-tormented shore,

.....

And I hold within my hand

.....

Grains of the golden sand —

.....
 How few! yet how they creep

 Through my fingers to the deep,

 While I weep — while I weep!

 O God! Can I not grasp

 Them with a tighter clasp?

 O God! can I not save

One from the pitiless wave?

 Is *all* that we see or seem

 But a dream within a dream?

Edgar Allan Poe

Analizë e punimeve krijuese

Në këtë pjesë të artikullit tonë paraqitet një analizë e shkurtër bazuar në disa prej punimeve të studentëve të qendrës së gjuhëve të huaja “Solution”. Studentët të cilët i janë nënshtruar këtyre aktiviteteve krijuese i përkasin grupmoshave dhe niveleve të ndryshme të gjuhës duke krijuar kështu një larmi në përdorimin e gjuhës së huaj.

Analiza do të përqendrohet në tri plane kryesore: në planin leksikor, në planin gramatikor dhe në atë estetik. Midis disa krijimeve poetike të realizuara kemi zgjedhur vetëm dy⁵ prej tyre për të ilustruar analizën tonë, krijimin poetik më të arrirë dhe atë më pak të arrirë.

5 Origjinalet e skanuara të punimeve të marra në analizë ndodhen në shtojcën në fund të artikullit.

Punimi nr. 1

Advice to my brother

Never trust a racist
 Never kill an animal
 Never sign a dating site
 Never go night life
 Don't enlist yourself in a party
 Nor crush girls hearts.
 Never write bullshits,
 Never scratch old wounds.
 Always put your finger in your body
 Don't believe lazy men.
 Keep your self away from rumors,
 Never force someone to be with you.
 Never pay to know other's secrets
 Never go to be outlaw
 Never trust those crawlers like poets,
 Or you will be a horned cow.
 All our beloved ones will leave us
 All of them will pass away
 So try to live the life with happiness
 If you haven't found a new way.

KOMENTI:

Punimi i mësipërm është një nga krijimet më të bukura të studentëve i cili është bazuar në ushtrimin 1 ku studentit i kërkohet të ndërtojë një tekst të ri poetik duke u bazuar në vargjet e para të poezisë së Ernest Heminguej për të vazhduar më tej me të njëjtën strukturë si shembulli i dhënë.

Ajo që vihet re që prej leximit të parë të kësaj poezie është ana leksikore e punimit, studenti sjell një krijim tejet të pasur nga ana leksikore duke shmangur përsëritjen e fjalëve dhe duke sjellë terma të rinj gjuhësorë për të realizuar një punim sa më poetik (*horned cow, put your finger in your body, crawlers etj*).

Përsa i përket anës strukturore dhe gramatikore të punimit, mund të thuhet se studenti i ka qëndruar besnik poezisë së Heminguej për nga ana strukturore, por pa u bërë kopje e origjinalit. Punimi paraqet gjithashtu një strukturë gramatikore për t'u vlerësuar, vargje të shkurtra, por të sakta nga ana gramatikore.

Krahas vlerësimit teknik të këtij punimi duhet përmendur gjithashtu dhe mesazhi që përcjell poezia e krijuar dhe notat e saj poetike. *Advice to my brother* fillimisht të jep përshtypjen e një letre drejtuar një vëllai më të vogël, i cili duhet të ketë parasysh një sërë këshillash e udhëzimesh nga një vëlla më i madh, por natyra letrare që e karakterizon punimin na shtyn të futemi më në thellësi për ta parë mesazhin e poezisë më kuptimplotë dhe më të gjerë se një udhëzues. Duke iu drejtuar vëllait të tij, autori në të njëjtën kohë i është drejtuar vetes po ashtu, i është drejtuar një miku, një të dashuri apo edhe një të panjohuri.

Punimi nr.2

A dream Within A dream

Take this kiss upon the brow!

You start feeling like princes

And, in parting from you now,

And every melody is times

Thus much let me avow —

You loved me more than now.

You are not wrong, who deem

A dream within a dream

That my days have been a dream;

And I don't have more force to dream

Yet if hope has flown away

I am more happy in that way.

In a night, or in a day,

In morning or in dark

In a vision, or in none,

After or before

Is it therefore the less gone?

Is this really dream?
 All that we see or seem
It's different dream
 Is but a dream within a dream.
I am quiet but
 I stand amid the roar
A cold wind blows
 Of a surf-tormented shore,
Someone asked me " what do you have" ?
 And I hold within my hand
My mouth smiled but my eyes cried
 Grains of the golden sand —
Come through my hand
 How few! yet how they creep
I've been hearing symphonies
 Through my fingers to the deep,
And when you are gone I feel incomplete
 While I weep — while I weep!
I never thought I'd find this feeling.
 O God! Can I not grasp
So you let...
 Them with a tighter clasp?
A special band of creation
 O God! can I not save
All humans ther?
One from the pitiless wave?
You're gone grow and have good life
 Is all that we see or seem
Can you stay away from me?
 But a dream within a dream?

KOMENTI:

Punimi i dytë që kemi përzgjedhur për të analizuar si krijimin më pak të arrirë është realizimi i ushtrimit nr. 2 ku studentit i kërkohet të ndërhyjë midis vargjeve të poezisë së Edgar Allan Poe për të rindërtuar një tekst të ri poetik i cili mund të jetë një zgjerim i poezisë «A dream within a dream» ose edhe një tjetërsim i saj, kryesisht nga ana kuptimore.

Studenti ka ndjekur me përpikmëri atë çfarë i është kërkuar në ushtrimin e propozuar duke u munduar të ruajë strukturën e poezisë dhe përpiqet të respektojë edhe rimën e përdorur në poezinë origjinale.

Elementi kryesor që e klasifikon këtë punim si më pak të arrirë është struktura gramatikore dhe ajo leksikore. Vargjet e paraqitura janë të varfra si pasojë e përdorimit të një fjalori jo shumë të pasur. Vihet re ripërsëritja e të njëjtave fjalë në disa vargje (*A dream within a dream, And I don't have more force to dream, Is this really dream?, It's different dream*).

Krahas kësaj, studenti shfaq gjithashtu disa probleme gramatikore, edhe këto të fundit të ripërsëritura, (*It's different a dream, You're gonne grow and have a good life*). Si pasojë e këtyre gabimeve gramatikore, një pjesë e vargjeve janë jo të plota nga ana kuptimore dhe në këtë mënyrë mesazhi që studentit synon të përcjellë me anë të vargjeve të tij mbetet disi i vështirë për t'u kuptuar nga lexuesi.

Përfundime

Duke mbajtur parasysh ndikimin e materialeve të tjera mësimore, puna që na është dashur të bëjmë me vendosjen e tekstit letrar në qendër të mësimdhënies, ka qenë impenjative pasi edhe interesi i nxënësve lidhur me letërsinë nuk është ai i duhuri.

Nëse i rikthehemi pyetjes së bërë në fillim të punimit, a ndihmon teksti poetik në mësimin e një gjuhe të huaj? Gjatë kërkimit tonë kemi konstatuar se teksti letrar dhe ai poetik i ofrojnë mësuesit, por edhe nxënësit një sërë mundësish për të punuar dhe për të realizuar projekte të ndryshme letrare. Në çdo situatë ku nxënësi është në kontakt me një tekst letrar, ai furnizohet me informacion të konsiderueshëm për ta trajtuar gjuhën në të gjitha rubrikat e saj.

Gjatë punimit tonë kemi konstatuar se të interesuarit për mësimin e një gjuhe të huaj nuk shfaqin asnjë lloj tërheqje apo interes kundrejt teksteve poetike, sidomos kjo si pasojë e dy faktorëve kryesorë: e para, përzgjedhja jo e duhur e metodave të gjuhëve të huaja të cilat shfaqin mungesë të theksuar të teksteve letrare dhe poetike në brendësi të tyre dhe e dyta, angazhimi i munguar nga ana e mësimeve të gjuhës për të përfshirë ata vetë tekste letrare, falë të cilëve ora mësimore do të ishte më e larmishme dhe si pasojë edhe më produktive. Këtë të fundit e kemi konstatuar nga ushtrimet e propozuara për studentët e qendrës “Solution”. Fillimisht kur këta studentë janë prezantuar me natyrën e ushtrimeve që do të punonin, kanë shfaqur një ndjenjë indiferentizmi, pasi pavarësisht nivelit të tyre të gjuhës, trajtimi i një teksti poetik u dukej tejet i vështirë dhe me shumë përgjegjësi. Të pyetur në lidhje me reagimin e tyre, përgjigjja e vetme ishte: - “Janë të vështira”. Pra, arsyeja e tyre tregon qartësisht se punimi i një teksti letrar në një gjuhë të huaj është diçka tërësisht e re për ta. Pavarësisht kësaj, fill pas shpjegimit të ushtrimeve interesi i tyre ndryshoi dhe punët e realizuara rezultuan vërtet të suksesshme.

Duke marrë shkas nga pjesa praktike e punimit tonë, krahas mundësive që ofrohen nga ana metodologjike për një orë mësimore apo interesit të nxënësve, duhet ritheksuar edhe një herë roli i mësuesit në këtë proces. Është detyra e mësuesit të orientojë dhe të inkurajojë nxënësit e tij rreth llojeve të aktiviteteve që u lejojnë atyre të zbulojnë gjuhën në të gjitha dimensionet e saj dhe njëkohësisht ta duan atë çka zbulojnë.

BIBLIOGRAFIA:

- BARA, S., BONVALLET, M. & RODIER, C. (2011), *Pourquoi des activités d'écriture créative en classe de FLE*. BIDAULT, M., CHORT, G., KABLAN, F. & TREFFANDIER, F. (2012), *Agenda 3*. Paris: Botimet Hachette.
- BIDAULT, M., CHORT, G., KABLAN, F. & TREFFANDIER, F. (2012), *Agenda 3: Guide pédagogique*. Paris: Botimet Hachette.
- COLLES, L. (2014), *La poésie en classe de FLE*. Marrë në adresën : <http://luc.colles.canalblog.com/archives/2014/07/05/30196665.html>
- DOLLEZ, C. & PONS, S. (2008), *Alter Ego 4*. Paris: Botimet Hachette.
- DOLLEZ, C., VASILJEVIC, I., BERTHET, A., HUMERY, J. & PONS, S. (2008), *Alter Ego 4: Guide pédagogique*. Paris: Botimet Hachette.

- EVANS, V. & DOOLEY, J. (2014). *On Screen B2+: Student's Book*, UK: Botimet Express Publishing.
- GEORGES, J. (1989), *À l'école de la poésie*.
- RUGGIERI, L., MAGNELL, S. & MARIN, T. (2013). *Progetto Italiano 2: Libro dello studente*, Romë: Botimet Edi Lingua
- MARCHAND, F. (1997), *Premièrs concours interne de progresseur des écoles*. Paris: Vuibert.
- MENAND, R., BERTHET, A. & KIRIZIAN, V. (2009), *Le nouveau taxi 2*. Paris: Botimet Hachette.
- MOUIGNOT, O. (2014), *L'atelier d'écriture créative en didactique du français langue étrangère*. Mémoire de master: Sciences du langage, Paris: Université Sorbonne Nouvelle – Paris 3.
- PATIN, M. (1848), *La poésie didactique à ses différents âges*.
- PUREN, CH. (1988), *Histoire des méthodologies de l'enseignement des langues*. Paris : Nathan-CLE International. Marrë në : <https://www.scribd.com/document/116810061/HISTOIRE-DES-METHODOLOGIES-DE-L-ENSEIGNEMENT-DES-LANGUES-Christian-PUREN>
- SALMAN, A. (n.d). *La production des textes poétiques en classe de Fle: de la découverte à la créativité*. Marrë në: http://eprints.aidenligne-francais-universite.auf.org/533/1/Production_poesie_Salman.pdf

SHTOJÇË

Punimi 1

1. Shkruani një tekst poetik duke u bazuar në vargjet e para të poezisë së Ernest Heminguej.

Advice to a Son

Never trust a white man,
Never kill a Jew,
Never sign a contract,
Never rent a pew.
Don't enlist in armies;
Nor marry many wives;
Never write for magazines;
Never scratch your hives.
Always put paper on the seat,
Don't believe in wars,
Keep yourself both clean and neat,
Never marry whores.
Never pay a blackmailer,
Never go to law,
Never trust a publisher,
Or you'll sleep on straw.
All your friends will leave you
All your friends will die
So lead a clean and wholesome life
And join them in the sky.

Advice to my brother

Never trust a racist
Never hurt an animal
Never sign a dating site
Never go night life
Don't enlist yourself in a party,
Nor crush girls hearts.
Never write bullshots,
never scratch old wounds
Always put your finger in your body
Don't believe lazy men.
Keep yourself away from rumors,
Never force someone to be with you.
Never pay to know other's secrets
Never go to be outlaw.
Never trust those crows like poets,
Or you will be a homed cow.
All our beloved ones will leave us
All of them will pass away
So try to live the life with happiness
Ernest Hemingway
if you haven't found a new way.

Ernest Hemingway

Punimi 2

3. Ndertoni një tekst poetik duke ndërhyrë midis vargjeve të poezisë së mëposhtme.

A dream Within A dream

Take this kiss upon the brow!

You start feeling like like prince

And, in parting from you now,

And every melody is times

Thus much let me avow —

You loved me more than now

You are not wrong, who deem

a dream within a dream

That my days have been a dream;

I don't have more force to dream

Yet if hope has flown away

I'm more happy in that way

In a night, or in a day,

In morning or in dark

In a vision, or in none,

After or before

Is it therefore the less gone?

Is this really dream?

All that we see or seem

It's different dream

Is but a dream within a dream.

I'm quite but

I stand amid the roar

A cold wind blows

Of a surf-tormented shore,

Someone asked me "what do you have"?

And I hold within my hand

Grains of the golden sand —
 Come through my hand
 How few! yet how they creep
 I've been hearing whispers
 Through my fingers to the deep,
 And when you're gone I feel incomplete
 While I weep — while I weep!
 I never thought I'd find this feeling
 O God! Can I not grasp
 So you let me
 Them with a tighter clasp?
 A special band of creation has
 O God! can I not save
 All humans there?
 One from the pitiless wave?
 You're gonna stay and have good life
 Is all that we see or seem
 Can you stay away from me?
 But a dream within a dream?

Edgar Allan Poe

Poez,

I never, letter of the ~~alpha~~ alphabet have a maker
 for us

Many makers, many vessels and word
 spirit

It doesn't have word to describe

Nor the epithet to compare

But are all
 Because is ^{not} just one.

But are all the best.